

“Ato netë në të cilat nuk arrin të vësh gjumë në sy sepse mund të jesh i trazuar në shpirt, fol me Bariun dhe pusho së numëruari delet”.

D.V.



# Kisha dhe Jeta

ORGAN I PËRMUAJSHËM INFORMACIONI I METROPOLISË TIRANË-DURRËS Nr. 9 NËNTOR 2016 Çmimi 30 lekë

## BARIU DËGJOFTË ZËRIN E DELEVE...!

Imzot George Frendo

Arqipeshkvi i ri  
i Arkidioqezës  
Tiranë-Durrës



Bariu dëgjoftë zërin e deleve *faqe 3-4*

Imzot George Frendo

*Curriculum Vitae* *faqe 5*

Bariu dëgjoftë zërin e deleve

GEORGE FRENDO O.P. / *faqe 6*

Urimi i Shkëlqesisë së tij  
Bujar Nishani President i  
Republikës së Shqipërisë, me  
rastin e përrimit të Imzot  
George Frendo si Arqipeshkëv i  
Arkidioqezës Tiranë -Durrës *faqe 6*

Urimi i Kryetarit të Parlamentit  
të Republikës së Shqipërisë z.  
Ilir Meta, me rastin e përrimit  
të Imzot George Frendo si  
Arqipeshkëv i Arkidioqezës  
Tiranë -Durrës *faqe 7*

Papa Françesku

Audienca dhe Engjëlli i Tënzot *faqe 7*

Lumnimi i 38 Martirëve të  
Shqipërisë Kard. Amato:  
Martirët protagonistë të  
historisë së njerëzimit *faqe 8-10*

Martirizimi i priftërinjve  
katolikë në shifra *faqe 10*

Katolikët e ortodoksët  
miratojnë dokumentin mbi  
primatin dhe sinodalitetin *faqe 11*

# Kalendari Liturgjik

## Dhjetor 2016

### Lindja e Jezu Krishtit

(Mateu 1, 18 - 25)

Lindja e Jezu Krishtit ndodhi kështu:

Maria, nëna e tij, pasi u fejuua me Jozefin, para se të banonin së bashku, u gjet shtatzënë për virtyt të Shpirtit Shenjt.

Tashti Jozefi, i fejuari i saj, pasi ishte njeri i drejtë e nuk donte ta çnderonte botërisht, mendoi ta lëshojë fshehtëazi. Posa në mendje të vet vendosi të bëjë kështu, ja se, iu duk në ëndërr engjëlli i Zotit dhe i tha: "Jozef, biri i Davidit, mos ki frikë ta marrësh Marinë, të fejuarën tënde, sepse foshnja që është zënë në të, u zu për virtyt të Shpirtit Shenjt. Ajo do të lindë djalë e ti ngjitja emrin Jezus, sepse Ai do ta shëlbojë popullin e vet prej mëkateve të tija." E gjithë kjo ngjau që të shkonte në vend fjala e Zotit e thënë nëpër profetin:

*"Qe, Virgjëra do të mbesë shtatzënë e do të lindë një djalë,*

*të cilit do t'ia ngjesin emrin Emanuel*

*që do të thotë: Hyji me ne!"*

Jozefi, si u zgjua nga gjumi, bëri sikurse i urdhëroi engjëlli i Zotit: e mori në shtëpi të fejuarën e vet. E, pa pasur marrëdhënie martesore me të, ajo lindi djalin, të cilit ia ngjiti emrin Jezus.



3 dhjetor – Sh. Françesk Ksavieri

04 dhjetor – E DIELA e II E ARDHJES (A), Sh. Gjoni i Damaskut

06 dhjetor – Sh. Nikolla

07 dhjetor – Sh. Ambrozi

08 dhjetor – ZOJA E PAPËRLYER

09 dhjetor – Sh. Gjon Didak Kuahtlatoatzin

11 dhjetor – E DIELA e III E ARDHJES (A), Sh. Damazi I

12 dhjetor – Sh. Maria V. e Guadalupe

13 dhjetor – Sh. Luçia

14 dhjetor – Sh. Gjoni i Kryqit

18 dhjetor – E DIELA e IV E ARDHJES (A)

21 dhjetor – Sh. Pjetër Kanizi

23 dhjetor – Sh. Gjoni nga Kety

25 dhjetor – KRISHTLINDJA

26 dhjetor – Sh. Shtjefni

27 dhjetor – Sh. Gjoni

28 dhjetor – Shenjtërit e pafajshëm

29 dhjetor – Tetëditëshi i Krishtlindjes, Sh. Toma Beket

30 dhjetor – Familja Shejte (A) (Festë)

31 dhjetor – Tetëditëshi i Krishtlindjes, Sh. Silvestri



**Drejtor i përgjithshëm:**

Imzot George Frendo

**Kryeredaktor:**

D. Marjan Lumçi

**Sekretar:**

Ferdinand Ndocaj

**Redaksia:**

Kolec Çefa

Ana Stakaj

Zef Skanjeti

Elidon Dodaj

**Grafika:**

Pjerin Sheldija

**Foto:** Pici

**Adresa:**

Katedralja e Shën Palit,

Bulevardi Zhan D'Ark,

Tiranë, Shqipëri

E-mail: kisha.jeta@gmail.com

www.kishadhejeta.com

# Bariu dëgjoftë zërin e deleve

Homelia e Imzot George Frendo në Meshën e përrurimit të tij  
si Arqipeshkëv i Arkidioqezës Tiranë-Durrës.

Tiranë me 3 dhjetor 2016



Rasti i sotëm më kujton atë ditë, para pak Rmë shumë se dhjetë vitesh, kur Imzot Rrok Mirdita më shuguroi ipeshkëv. Sot dua të shpreh edhe një herë mirënjohjen time ndaj tij, atit të kësaj arkidioqeze. Gjithçka në këtë Kishë Katedrale na kujton personin dhe angazhimin e tij. Zoti e shpërbleftë për dashurinë e tij për Kishën, për popullin shqiptar, dhe për dioqezën që vetë Zoti ia kishte besuar.

Pikërisht para 50 viteve, qeveria komuniste shqiptare mori këtë vendim: “Të shpronësohet Kisha Katolike e ndodhur në Bulevard ‘Stalin’ (Tiranë). Të shpronësohet dhe të shembet”. Sot nuk ekziston më ajo kishë, e ndërtuar në vitin 1856, por sot kemi këtë Katedrale, e ndërtuar përballë Mausoleumit që kishte ndërtuar për veten e tij ai i cili kishte vendosur të vriste Zotin.

Leximet që kemi dëgjuar janë po të njëjtat që kisha zgjedhur atë ditë kur u shugurova ipeshkëv, por sot për mua kanë një domethënie tjetër. Leximi i parë na foli për thirrjen e Jeremisë profet. Jeremia kishte frikë, sepse i tha Zotit, “Jam fëmijë”. Unë nuk mund të them, si Jeremia, se “jam fëmijë”, por rrëfej singërisht se edhe unë kam frikë të pranoj këtë përgjegjësi të re dhe të madhe. Megjithatë Zoti më thotë ashtu sikurse i tha edhe Jeremisë: “Mos ki frikë, unë jam me ty”. Në Leximin e dytë Shën Pali më kujton se, si përfaqësues i Krishtit, jam mbarështues i pajtimit mes popullit dhe Hyjit dhe mes njerëzve me njëri-tjetrin, ndërsa Ungjilli na flet për takimin e Krishtit të ngjallur me Pjetrin. Tri herë rresht Jezusi e pyet Pjetrin: “A më do ti?” – duke i ngarukar detyrën për të kullotur delet e tij. Sot e dëgjoj Jezusin që, duke më thirrur me emër, më pyet: “George, a më do ti?” dhe m’i beson delet e tij në këtë dioqezë.

Vëllezër e motra, më lejoni tani t’u drejtohem kategorive të ndryshme të pranishme këtu.

Së pari u drejtohem meshtarëve dhe regulltarëve. Ata i nxis veçanërisht që të vlerësojnë thjeshtësinë dhe varfërinë ungjillore. E theksoj këtë fjalë: ungjillore. Pra nuk bëhet fjalë për atë thjeshtësi që është naivitet. Madje Jezusi na ka thënë të jemi “të zgjuar si gjarpërinjtë”. Nuk është fjala as për varfërinë shoqërore. Ne duhet ta luftojmë varfërinë shoqërore, sepse ekzistenca e të varfërve në shoqëri është gjithmonë provë e egoizmit, e padrejtësisë dhe korrupsionit, është provë se nuk po zbatohet plani dhe vullneti i Zotit, i cili ua besoi njerëzve, të gjithë njerëzve, pasurinë e tokës. Kurse varfëria ungjillore është urtia e atyre që kanë gjetur thesarin e fshehur të Mbretërisë së qiellit. Ata kanë kuptuar se është urtësi e vërtetë të grumbullojnë thesaret në qiell sesa këtu mbi tokë. Por kanë kuptuar gjithashtu se thjeshtësia dhe varfëria ungjillore na bëjnë dëshmitarë më të besueshëm të Krishtit, i cili vetë ishte i varfër dhe i kishte shumë për zemër të varfrit. Shoqëria shkandullohet jo vetëm nëse mëkatojmë në fushën e seksualitetit, por edhe nëse na sheh lakmues për t’u pasuruar. Ja pse Shën Françesku, me thjeshtësinë e tij, ka tërhequr admirimin e popujve deri më sot; ja pse Shën Dominiku, i varfër, me predikimin e tij ka bindur shumë heretikë të heqin dorë nga jeta e tyre dhe të kthehen në Kishën e Krishtit; ja pse Shën Tereza, të cilën ne vazhdojmë ta thërrasim “Nënë Tereza”, u bë ndoshta personi më popullor i shekullit XX. Ungjijtë përsërisin disa herë se Jezusi “fliste me autoritet”. Flasim ne me këtë autoritet? Fjalët tona a janë shoqëruar nga jeta dhe veprat tona? Njerëzit a shohin në ne Krishtin in persona?

U drejtohem së dyti të gjithë besimtarëve tanë. Kisha nuk është tempulli i ndërtuar me gurë të pajetë. Shën Pali thotë se secili prej nesh është “tempull i Hyjit”, ndërsa Shën Pjetri na thërret “gurë të gjallë”. Si mund të imagjinojmë një gurë të gjallë? Ezekjeli profet flet për eshtrat e thatë që morën mish dhe frymë. Zoti bën që ne, gurë të pajetë, të marrim frymë dhe të bëhemi “gurë të gjallë”. Mos jini vetëm nxënës të Krishtit. Jini gjithashtu apostuj, të dërguar të Krishtit. Ishte kjo arsyeja pse keni pranuar sakramentin e krezmimit, që të bëheni dëshmitarë, apostuj të Krishtit. Le të ndërtojmë së bashku Kishën e Krishtit në dioqezën tonë të Tiranë-Durrësit. Le ta falënderojmë Zotin për mrekullitë që ka bërë me dioqezën tonë gjatë këtyre njëzet e pesë viteve të fundit, por rrugëtimi ynë nuk është ndaluar: duhet të vazhdojë. Mos të kemi frikë të bëjmë reformat e duhura, mos të kemi frikë të ndryshojmë strukturat. Por mos të harrojmë se puna më e rëndësishme dhe më e vështirë nuk është ndryshimi i strukturave, por ndryshimi i zemrës. Reformat, vetëm, nuk janë të afta t’i ndryshojnë zemrat. Vetëm me anë të fesë dhe të dashurisë mund t’i ndryshojnë zemrat, dhe duke përdorur një shprehje të Papa Françeskut ju them: “le të ndërtojmë ura, dhe jo mure”. Së bashku le të ndërtojmë një kishë sipas modelit që na paraqet Papa Françesku: një kishë që pasqyron shpirtin e Krishtit në thjeshtësi dhe përvujtëri, një Kishë që shërben, afër popullit veçanërisht të varfërve, të braktisurve, të mënjanuarve për shkak të ngjyrës ose të gjendjes së tyre shoqërore, viktimave të padrejtësisë, një Kishë që bëhet për ata që s’kanë zë.





Prandaj le t'u buzëqeshim atyre që kërkojnë solidaritetin tonë, le t'u japim dorën atyre të cilëve ua kishim mohuar, le t'i zgjerojmë zemrat tona që të varfërit dhe të mënjanuarit të gjejnë në to vend strehimi.

U drejtohem së treti politikanëve. Kam shumë respekt për ju, sepse ju jeni në shërbim të popullit për të mirën e përbashkët. E mira e përbashkët ka përparësi mbi të mirën e partisë. Misioni juaj si politikanë ju afron me popullin. Në fjalimin e saj të parë si kryeministre e Britanisë së Madhe, Tereza Mei foli rreth drejtësisë shoqërore. Ajo tha se kjo do të thotë "të luftosh padrejtësinë e padurueshme ku, nëse ti lind i varfër, vdes mesatarisht 9 vjet më herët se të tjerët; nëse je me ngjyrë, trajtohesh më rreptë se të bardhët nga sistemi gjyqësor; nëse je i bardhë, por je klasë punëtore, ke shanse më të pakta se të tjerët të ndjekësh universitetin; nëse arsimohesh në shkollë publike ke më pak gjasa të kapësh poste të larta se ata që arsimohen në shkollë private; nëse je femër paguhesh më pak se meshkujt; nëse ke probleme mendore, nuk gjen ndihmë të mjaftueshme dhe nëse je i ri e ke shumë më të vështirë se dikur për t'u bërë me një shtëpi tënden." E dini sa shumë Kisha i ka për zemër të varfërit dhe të mënjanuarit. Por Kisha nuk mund të zëvendësojë qeverinë. Jemi komplimentar në luftën tonë kundër korrupsionit dhe padrejtësisë dhe në mbrojtjen e të varfërve dhe të mënjanuarve. Është politika që mund të ndryshojë strukturat për një shoqëri më të pastër dhe më të drejtë; por janë besimet që

mund të ndryshojnë zemrat për një shoqëri më vëllazërore dhe më paqësore.

Tani ju drejtohem juve, të rinjtë, shpresa e së ardhmes tonë. E di mirë se shumë prej jush kanë vetëm një ëndërr: që të shkoni në një vend të huaj ku mendoni se do të gjeni një parajsë tokësore, sepse do të pasuroheni brenda pak ditësh! Së pari dua t'ju referoj mësimin e Shën Tomës nga Aquino, domethënë së virtyti i dashurisë përfshin dashurinë për atdheun. Duajeni atdheun tuaj! Shqipëria jo vetëm që është një vend shumë i bukur, por është nëna që ju ka mësuar shumë vlera pozitive. Ju jeni trashëgimtarë të një kulture mikpritësie, në një botë që na mëson anonimitetin; jeni trashëgimtarë të një kulture solidariteti me njerëzit që kanë pësuar fatkeqësi; jeni trashëgimtarë të një kulture që tregon respekt të madh ndaj të moshuarve, që në shumë vende sot çmohen si një peshë për shoqërinë; jeni trashëgimtarë të shumë vlerave që shumë vende më të pasura financiarisht i ka përzier me mbeturina.

Por ju duajeni atdheun që ju ka pasuruar me këto vlera. Tregohuni gjithmonë guximtarë duke menduar si mund ta bëni atdheun tuaj gjithmonë më të mirë, më të drejtë, më të pastër. Gjithashtu tregohuni guximtarë edhe nëse Zoti ju thërret për një jetë ku mund t'i shërbeni Kishës në mënyrë më rrënjësore, si meshtarë ose si motra. Kemi shumë nevojë për të rinj dhe të reja të gatshëm të jenë më shumë bujarë me Zotin dhe që nuk kanë frikë t'i thonë Zotit: "Po, o Zot, ja ku jam! Dua të të shërbej si meshtar, si frat, si murgëshë".

Dhe së fundi ju drejtohem juve, të dashur përfaqësues të besimeve në Shqipëri. Ashtu si pasardhësi im, i ndjeri Imzot Rrok Mirdita, edhe unë dua të jem vegël për promovimin e harmonisë ndërfaqësore.

Një përshëndetje vëllazërore dhe të përzemërt ndaj udhëheqësve dhe besimtarëve të kishës Ortodokse, vëllazërit tanë në besimin e krishterë. Së bashku le të jemi frymëzim për të krishterët në Shqipëri dhe në mbarë botën dhe t'i lutemi Zotit me zell të përtërirë për bashkimin e plotë të të gjithë nxënësit e tij. Vendi ynë pret prej nesh një dëshmi bindëse të krishterë në të gjitha sferat e jetës, personale dhe shoqërore. E ardhmja e njerëzimit do të varet shumë nga aftësia jonë për të dhënë dëshmi të përbashkët për Shpirtin e së vërtetës, në këto kohëra të vështira.

Përshëndes gjithashtu përfaqësuesit e Kishës Ungjillore. Bashkohem me ju në lutje në përvjetorin e 500-të të Reformimit Protestant. ADN-ja ime si Dominikan dhe formimi im së bashku me zellin tim apostolik, përforcojnë bindjen time se ne nuk mund të qëndrojmë pasiv në qetësinë të ndërtesave tona kishtarë; kemi nevojë të kalojmë nga një baritorja të thjeshtë të ruajtjes tek një shërbim baritor përfundimtar misionar.

Tani u drejtohem Myslimanëve dhe Bektashianëve, që janë përfaqësuar këtu nga udhëheqësit e tyre. Në shekullin njëmbëdhjetë, Papa Gregori VII i shkroi një letër Mbretit të Mauritanisë, Al-Nasir, që ishte musliman. Në këtë letër Papa i drejtohet atij me fjalët "vëllai im në Abrahamin, besimtar në Hyjin, një dhe krijues".



Në vitin 1965 Koncili II i Vatikanit botoi deklaratën *Nostra Aetate*, që flet për marrëdhëniet mes Kishës Katolike dhe besimeve jo-të krishtera. Në këtë dokument, Koncili shprehet se Kisha ka shumë respekt për Muslimanët, të cilët adhurojnë një Hyj të vetëm dhe të amshuar, të mëshirshëm dhe të gjithëpushtetshëm. Dhe këto pohime na ftojnë t'i vlerësojmë më shumë të vërtetat dhe vlerat e përbashkëta që duhet të na angazhojnë për ndërtimin i një shoqërie më të denjë për njeriun. Sepse, si besimi i krishterë, ashtu edhe besimi mysliman dhe bektashian, i

njohin njeriut një dinjitet të veçantë në krijim. Në Kuran lexojmë fjalët e Allahut: "Dhe kur Zoti yt u tha engjëjve: 'Unë krijova në tokë zëvendës'". Dhe poeti i famshëm Bektashian Naim Frashëri ka shkruar: "Zemra e njeriut në jetë – është vendi i Perendisë – atje është Zoti i vërtetë – deti i madh i gjithësisë".

Vëllezër e motra, kemi filluar këtë meshë duke kërkuar mëshirën e Zotit. Dhe unë dua të mbaroj këtë fjalë duke kërkuar mëshirën tuaj. M'i falni gabimet e mia. Unë nuk gëzoj dhuratën e pagabueshmërisë. E di se kam gabuar

shumë në jetën time. Do të bëj çmos mos të përsëris të njëjtat gabime, por nuk mund të jap asnjë garanci se nuk do të bëj gabime të reja. Që nga tani kërkoj mirëkuptimin dhe faljen tuaj.

Lutuni për mua, që Zoti të jetë gjithmonë drita ime për të mirën e grigjës që Ai i'a ka besuar një personi të dobët sikurse jam unë. Faleminderit për praninë tuaj edhe për dashurinë e madhe që gjithmonë më keni treguar, sigurisht pa e merituar. Faleminderit, faleminderit shumë! Jam vëllai juaj Gjergj.

## Imzot GEORGE FRENDO

### *Curriculum Vitae*



At Gjergji (emri i pagëzimit **Antonio**) ka lindur më 4 prill 1946 në Qormi, Maltë (i pesti në një familje prej shtatë fëmijësh). Pasi përfundoi studimet fillore dhe të mesme, hyri në Urdhrin e Predikatarëve apo Dominikan, në vitin 1962 dhe në vitin 1963 bëri kushtet e para. Ndoqi studimet për filozofi e teologji pranë *Kolegjit Filozofik- Teologjik Sancti*

*Thomae Aquinatis* në Rabat, të Maltës. Kushtet e përjetshme në prill 1967 dhe u shugurua meshtar më 7 prill 1969.

#### STUDIMET DHE MËSIMDHËNIA

Është diplomuar si Lektor në Teologji të Shenjtë, me tezën *Pagëzimi si Sakramenti i Fesë në Doktrinën dhe praktikën e Kishës*. Ka vazhduar pastaj studimet në Pontificia Universitas Sancti Thomae Aquinatis në Romë, në Fakultetin e të Drejtës Kanonike, e në vitin 1973 u diplomua në Drejtën Kanonike me tezën *Pazgjidhshmëria dhe Divorci në Teologjinë e Teologëve të shekullit të 13-të*. Me t'u kthyer në Maltë nisi menjëherë të japë Teologji dogmatike pranë Kolegjit Domenikan Filozofik-Teologjik Sancti Thomae Aquinatis, duke dhënë disa kurse të Teologjisë Dogmatike (mbi sakramentet e Inicimit dhe Eskatologjinë) në Fakultetin e Teologjisë në Maltë dhe një kurs mbi Ateizmin Bashkëkohor në Seminarin e Gozës. Në Shqipëri ka dhënë Teologji Trinitare dhe Kristologji në Seminarin Ndër-dioqezan në Shkodër.

#### ZYRAT DOMINIKANE

1974-1979: Mësues i rishtarëve dhe studentëve  
1979-1981: epror kuvendi  
1981-1989: famullitar në një famulli domenikane në Maltë  
1989-1997: Provincial i Dominikanëve në Maltë  
1992-1996: Kryetar i Konferencës së eprorëve të lartë në Maltë

#### ZYRAT E ARKIDIOQEZËS SË MALTËS

1974-1976: Defensor Vinculi i Gjykatës së Shkallës së Parë  
1976-1980: Defensor Vinculi i Gjykatës Ndër-Dioqezane së shkallës së dytë  
1980-1989: Gjyqtari i Gjykatës Ndër-Dioqezane të shkallës së dytë.  
Anëtar i Komitetit të ngritur nga Konferenca Episkopale malteze për të hartuar rregullat plotësuese pas shpalljes së Kodit të ri të Ligjit Kanonik.

#### DETYRAT NE KISHËN E SHQIPËRISË

1997-1999: Përgjegjës për përgatitjen e standardeve plotësuese pas shpalljes së Kodit të ri të Ligjit Kanonik.  
1998 -: Vikar i Përgjithshëm i arkidioqezës Tiranë-Durrës  
1999-2005: Kryetar i Konferencës së eprorëve më të lartë në Shqipëri  
2001-2006: Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm evropian të UCESM  
2001 - 2006: *Vicarius Judicialis* i Gjykatës Ndër-Dioqezane (e shkallës së parë)  
Nga 23 shtator 2006: ipeshkvi ndihmës i Tiranës.  
Në vitin 2007 ai u emërua anëtar i Këshillit Papnor për Dialogun Ndërfetar.  
Është autor i disa librave të natyrës doktrimore apo shpirtërore (si p.sh., mbi Eukaristinë, sakramentet, Marinë e Shenjtë, tre librave mbi temat për tre vitet e përgatitjes për jubileun e madh, familjen, një sintezë të Katekizmit të Kishës Katolike, adhurimin eukaristik, etj).  
Ka pasur gjithashtu përvojë për shumë takime ndërkombëtare, si epror provincial i Dominikanëve në Maltë, ashtu edhe si president i Konferencës së Eprorëve më të lartë në Maltë dhe Shqipëri, qoftë si anëtar i Ekzekutivit të *Unio Conferentiarum Europearum Superiorum Maiorum*, ashtu edhe si një delegat në emër të Konferencës Ipeshknore Shqiptare.  
Aktualisht është Sekretar i Përgjithshëm i Konferencës Ipeshkvoe dhe deri ne emërimin e tij si Arqipeshkëv i Tiranë-Durrësit ka qene Administrator dioqezan i Arkidioqezës Tiranë-Durrës.

# Bariu dëgjoftë zërin e deleve

GEORGE FRENDO O.P. /

Të dashur vëllezër e motra, jam vëllau juaj Gjergji.

Faleminderit se keni ardhur në këtë kohë sigurisht jo shumë e përshtatshme, veçanërisht për ata që kanë ardhur nga larg. Sigurisht të gjithë ju keni pritur me shumë padurim këtë ditë. Dhe sot ja ku jam, unë, i frikësuar i dobët, i padenjë. Një detyrë që nuk e kam kërkuar unë. Dhe i lutem Jezu Krishtit të më bëjë të fortë e të denjë që ta zbatojë këtë detyrë si shërbim sipas gjurmëve të tij, që erdhi jo për të qenë shërbyer, por për të shërbyer. Shpresa ime është Zoti, që më mbështet. Shpresa ime jeni edhe ju, që gjatë viteve në të cilat kam qenë dora e djathtë e të ndjerit Mons. Rrok Mirdita, keni treguar gjithmonë respekt të madh ndaj meje, sigurisht më shumë sesa meritova.

E ndoshta tani jeni kurajoz të dini cili do të jetë programi i Arqipeshkvit të ri. Së pari, dua të mbaj gjithmonë parasysh shembullin e Papa Françeskut, apostull i madh i thjeshtësisë ungjillore, i mbrojtjes së të pambrojturve, i mëshirës së Zotit. Së dyti, duhet të vazhdojmë të ndërtojmë mbi të mirat që kemi trashëguar nga Mons. Mirdita, Arqipeshkvi i parë i kësaj arkidioqeze të re, sepse ishte ai që ka shtruar themelet e kësaj arkidioqeze.

Natyrisht, disa reforma janë shumë të dobishme. Dhe kërkoj bashkëpunimin tuaj që këto reforma të realizohen, sepse reformat



sjellin domosdoshmërisht ndryshim edhe në punët që mund të keni zbatuar deri tani. Së pari, reforma e Kuries, që të bëhet më shumë "shtëpia e të gjithëve". Figura më e rëndësishme në Kuria është figura e Vikarit të Përgjithshëm, që duhet ta caktoj së shpejti pas përrurimit tim si Arqipeshkëv. Duhet të banojë këtu, si kam

qenë unë gjatë këtyre dhjetë viteve të fundit. Figura e dytë është ajo e Kancelarit, i cili është edhe moderatori i Kuries – një detyrë deri tani e kryer me shumë besnikëri dhe angazhim nga Dom Henri, i cili sigurisht do të vazhdojë në këtë detyrë.

Struktura të tjera që shpresoj të ndërtohen ose rindërtohen shpejt janë, për shembull, kolegji i konsultorëve, këshilli presbiterial, këshilli dioqezan financiar, këshilli baritor, si edhe emërim i disa zyrtarëve dioqezanë.

Por mbi të gjitha duhet t'i forcojmë së bashku komunikimin mes nesh që të dukemi më shumë si Kishë e gjallë, Trupi i gjallë i Krishtit, ku çdo organ i këtij Trupi të kuptojë se është i rëndësishëm për funksionim të mirë të Trupit. Afër të varfërve dhe të mënjauarve, me atë integritet që na bën njerëz të besueshëm. Vetëm kështu mund të flasim me autoritet dhe vetëm kështu fjala dhe vepra jonë mund të jetë "sakramentale".

Përrurimi im si Arqipeshkëv do të mbahet të shtunën më 3 dhjetor. Një ditë përpara, d.m.th. të premten 2 dhjetor në orën 12.30 do të organizojmë një drekë për disa të varfër në dioqezën tonë. Po atë ditë, në çdo kishë të arkidioqezës, të organizohet një gjysmë ore lutjeje për Arqipeshkvi e ri dhe për arkidioqezën.

Edhe një herë, faleminderit për praninë tuaj, për lutjet tuaja, dhe për mbështetjen tuaj.

## Urimi i Shkëlqesisë së tij Bujar Nishani President i Republikës së Shqipërisë, me rastin e përrurimit të Imzot George Frendo si Arqipeshkëv i Arkidioqezës Tiranë -Durrës

Fort i nderuar Imzot Frendo,

Emërimi juaj nga Ati i Shenjtë, Papa Françesku si Arqipeshkëv i Dioqezës së Tiranës dhe Durrësit, më jep kënaqësinë dhe privilegjin që edhe në emër të qytetarëve shqiptarë, t'ju përcjell urimet me të përzemërta për përmbushjen me sukses të kësaj detyre të rëndësishme shpirtërore dhe kishtarë.

Shpreh bindjen time se nën kujdesin dhe drejtimin tuaj të devotshëm, roli i Kishës Katolike, si simbol i angazhimit në jetën sociale, duke ndihmuar bashkëzistencën, tolerancën e bashkëpunimin në vendin tonë, do të vazhdojë më tej, duke dhënë ndihmesën dhe kontributin e vet të çmuar që Shqipëria të mbetet shembulli i rrallë i bashkëjetesës, harmonisë, respektit dhe mirëkuptimit shekullor midis besimeve të ndryshme fetare.

Shërbimi dhe përkujdesja juaj e vyer prej vitesh në Shqipëri, veçanërisht ndaj personave në nevojë si dhe devotshmëria juaj e madhe në përkthimin në gjuhën shqipe të teksteve liturgjike, duke kontribuar në përhapjen e mesazheve të paqes, zhvillimit shpirtëror e edukativ që feja përçon, larg çdo lloj fundamentalizmi apo ekstremizmi, kanë treguar dhe vërtetuar më së miri edhe dashurinë tuaj të sinqertë për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Duke ju shprehur edhe një herë urimet më të mira për mbarësi e suksese në detyrën tuaj.



# Urimi i Kryetarit të Parlamentit të Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta, me rastin e përrurimit të Imzot George Frendo si Arqipeshkëv i Arkidioqezës Tiranë -Durrës

Shumë i nderuar Arqipeshkëv i Arkidioqezës Metropolitane Tiranë-Durrës, Imzot George Frendo, kam kënaqësinë e posaçme t'ju uroj në Përrurimin Tuaj në këtë detyrë të lartë dhe jashtëzakonisht të rëndësishme. Kam shpresën e palëkundur dhe bindjen e pakthyeshme se Ju do të lini gjurmë të fortë në drejtimin e kësaj Arkidioqeze.

Shqipëria është atdheu i Nënë Terezës, Shenjtores së të varfërve, Qytetares së madhe të të gjithë botës dhe bijës së katolicizmit. Nëna e Shenjtë Terezë na mëson se: "mbase nuk mund të bëjmë dot gjëra të mëdha në të përditshmen tonë, por mund të bëjmë vepra të vogla me dashuri të madhe". Dhe Shqipëria ka nevojë për dashuri. Ka nevojë për besim dhe shpresë. Dhe besimi në Perëndi është një nga ato mundësi të lumtura që i afrojnë qytetarit më shumë dashuri dhe shpresë.

Unë lutem dhe shpresoj se Ju do ta ngrini në një shkallë më të lartë këtë mundësi.

"Më i rëndësishëm është ndërtimi moral sesa ekonomik i një vendi", ka thënë Ati i Shenjtë Papa Francesku gjatë vizitës së Tij në Tiranë. Edhe unë besoj modestisht se kjo është një nga të vërtetat drithëruese që duhet të na ndriçojnë në punën e përditshme, për të na dhënë vizionin e duhur dhe forcën e nevojshme për të kuptuar se për çfarë ka më shumë nevojë shoqëria shqiptare, e cila ka qenë dhe është në thelb një shoqëri evropiane.

Unë besoj se duke u kujdesur për besimtarët Tuaj, duke ndriçuar mendjet e tyre dhe duke ngrohur shpirtërat e tyre, ju do të gjeni rast të preknë, shihni dhe kontaktoni dhe me qytetarë të besimeve të tjera.

"Harmonia fetare në Shqipëri duhet të konsiderohet si dhuratë e Zotit, dhuratë e cila duhet ruajtur me kujdes, pasi ajo është thelbësore për lirinë tonë. Jemi të gjithë vëllezër dhe liria e besimit është kundër çdo lloj totalitarizimi dhe dhune". Ky ka qenë gjithashtu një nga mesazhet e Papa Franceskut kur vizitoi tokën tonë. Është kështu dhe kështu do të jetë për gjithmonë.

Besoj se dhe Ju, në ushtrimin e misionit Tuaj të lartë do të vendosni një gur të cmuar në urën e madhe të bashkëpunimit, bashkëjetesës dhe tolerancës ndërfaqetare në Shqipëri, si një shembull që shoqëritë e sotme moderne në Evropë do të duhej ta ndjekin në përditshmërinë e tyre, shpesh shumë të trazuar e të turbullt.



**KUVENDI I SHQIPËRISË  
KRYETARI**

Tiranë, më 3 dhjetor 2016

Shumë i nderuar Arqipeshkëv i Arkidioqezës Metropolitane Tiranë-Durrës, Imzot George Frendo,

kam kënaqësinë e posaçme t'ju uroj në Përrurimin Tuaj në këtë detyrë të lartë dhe jashtëzakonisht të rëndësishme. Kam shpresën e palëkundur dhe bindjen e pakthyeshme se Ju do të lini gjurmë të fortë në drejtimin e kësaj Arkidioqeze.

Shqipëria është atdheu i Nënë Terezës, Shenjtores së të varfërve, Qytetares së madhe të të gjithë botës dhe bijës së katolicizmit. Nëna e Shenjtë Terezë na mëson se: "mbase nuk mund të bëjmë dot gjëra të mëdha në të përditshmen tonë, por mund të bëjmë vepra të vogla me dashuri të madhe". Dhe Shqipëria ka nevojë për dashuri. Ka nevojë për besim dhe shpresë. Dhe besimi në Perëndi është një nga ato mundësi të lumtura që i afrojnë qytetarit më shumë dashuri dhe shpresë.

Unë lutem dhe shpresoj se Ju do ta ngrini në një shkallë më të lartë këtë mundësi.

"Më i rëndësishëm është ndërtimi moral sesa ekonomik i një vendi", ka thënë Ati i Shenjtë Papa Francesku gjatë vizitës së Tij në Tiranë. Edhe unë besoj modestisht se kjo është një nga të vërtetat drithëruese që duhet të na ndriçojnë në punën e përditshme, për të na dhënë vizionin e duhur dhe forcën e nevojshme për të kuptuar se për çfarë ka më shumë nevojë shoqëria shqiptare, e cila ka qenë dhe është në thelb një shoqëri evropiane.

Unë besoj se duke u kujdesur për besimtarët Tuaj, duke ndriçuar mendjet e tyre dhe duke ngrohur shpirtërat e tyre, ju do të gjeni rast të preknë, shihni dhe kontaktoni dhe me qytetarë të besimeve të tjera.

"Harmonia fetare në Shqipëri duhet të konsiderohet si dhuratë e Zotit, dhuratë e cila duhet ruajtur me kujdes, pasi ajo është thelbësore për lirinë tonë. Jemi të gjithë vëllezër dhe liria e besimit është kundër çdo lloj totalitarizimi dhe dhune". Ky ka qenë gjithashtu një nga mesazhet e Papa Franceskut kur vizitoi tokën tonë. Është kështu dhe kështu do të jetë për gjithmonë.

Besoj se dhe Ju, në ushtrimin e misionit Tuaj të lartë do të vendosni një gur të cmuar në urën e madhe të bashkëpunimit, bashkëjetesës dhe tolerancës ndërfaqetare në Shqipëri, si një shembull që shoqëritë e sotme moderne në Evropë do të duhej ta ndjekin në përditshmërinë e tyre, shpesh shumë të trazuar e të turbullt.

Pres me padurim t'ju takoj për t'ju uruar personalisht dhe t'ju siguroj për respektin dhe mirënjohjen time të thellë për Ju dhe misionin Tuaj në Shqipëri.

**Miqësisht**  
**Ilir META**

Pres me padurim t'ju takoj për t'ju uruar personalisht dhe t'ju siguroj për respektin dhe mirënjohjen time të thellë për Ju dhe misionin Tuaj në Shqipëri.

**Miqësisht**  
**Ilir META**

## Papa Françesku Audienca dhe Engjëlli i Tënzot Papa Françesku kujton Martirët e Lum shqiptarë në Engjëllin e Tënzot

Emrat e Martirëve shqiptarë, që u lumnuan dje në Katedralen e Shën Shtjefnit, u shqiptuan përsëri: sot, para turmës shumëkombëshe, mbledhur në Sheshin e Shën Pjetrit, për t'u lutur me Papën, i cili sapo kishte përfunduar Meshën e Jubileut të të burgosurve, duke kërkuar për ta një akt zemërbutesie.

"Dje, në Shkodër, në Shqipëri, u shpallën të Lum tridhjetë e tetë Martirë: dy ipeshkvij, shumë priftërinj e rregulltarë, një seminarist e disa laikë, viktimat të persekutimit të egër të regjimit ateist, që sundoi gjatë në këtë vend në shekullin e kaluar. Ata parapëlqyen burgun, torturat e, së fundi edhe vdekjen, për t'i qëndruar besnikë Krishtit e Kishës. Shembulli i tyre na ndihmoftë ta gjejmë, në Zotin, forcën që të mbështet në çaste të vështira e që të frymëzon sjellje mirësie, faljeje, paqeje".



# Lumnimi i 38 Martirëve të Shqipërisë

## Kard. Amato: Martirët protagonistë të historisë së njerëzimit

Shkodër 5 nëntor 2016

Në Shkodër u kremtua Mesha solemne me ritin e Lumnimit të 38 martirëve të Kishës katolike të periudhës së regjimit diktatorial ateist të komunizmit.

Mesha solemne, në Katedralen e Shkodrës, u kryesua nga Kardinali Angelo Amato, Prefekt i Kongregatës së Selisë së Shenjtë për Çështjen e Shenjtorëve, në bashkëkremtim me Presidentin e Konferencës Ipeshkëvnore Katolike të Shqipërisë, imzot Angelo Massafra e me tërë episkopatën e Shqipërisë, ipeshkvijtë tjerë nga Kosova, Mali Zi, Italia, Kroacia e shumë vende tjera.

Në Meshën dhe ritin e Lumnimit të 38 Martirëve në Katedralen e Shkodrës dhe sheshin para këtij Tempulli të Zotit, morën pjesë me dhjetëra mijëra besimtarë e qytetarë nga mbarë Shqipëria, nga Kosova, Mali Zi, diaspora e vendet tjera. Po kështu në Meshë genë të pranishme autoritetet e larta Shtetërore e qeveritare të Shqipërisë e të Kosovës, si dhe kryetarë të komuniteteve fetare të vendit.

Prekëse fjalët e Kryepeshkvit imzot Massafres në fillimin e Meshës, më paraqitjen nga një të gjithë emrave të Martirëve, të cilët u shpallen të Lumë gjatë këtij kremtimi liturgji.. **E pas këngës së Meshës, Arqipeshkvi Angelo Massafra e falënderoi Papën:**

*"Shumë e nderuar Eminencë, si Metropolitë e Arqidioqezës së Shkodër-Pultit, me përvujtëri kam kërkuar prej Atit të Shenjtë Françesk që të shruajë në numrin e të Lumëve Shërbëtorët e Hyjit Vinçenc Prenushi, ipeshkëv, dhe Shokët, Martirë".*

*"Eminenca shumë e nderuar, në emrin tim personal, e të Arqidioqezës sonë dhe të Postulacionit për Çështjen e Lumnimit, duke falënderuar Hyjin i cili, nëpërmjet martirëve tanë, na dha shembull e qëndrimit të fortë në fe deri në vdekje, Ju lutem*



*të paraqisni Shenjtërisë së Tij Papë Françeskut mirënjohjen tone për dhuratën që i fali tokës Shqiptare duke pranuar t'i numërojë ndër të Lumet edhe Shërbëtorët e Hyjit Ipeshkvin Vinçenc dhe Shokët e tij, Martirë".*

Gjatë Meshës, Arqipeshkvi Angelo Massafra e falënderoi Papën:

*"Eminenca shumë e nderuar, në emrin tim personal, e të Arqidioqezës sonë dhe të Postulacionit për Çështjen e Lumnimit, duke falënderuar Hyjin i cili, nëpërmjet martirëve tanë, na dha shembull e qëndrimit të fortë në fe deri në vdekje, Ju lutem t'i paraqisni Shenjtërisë së Tij Papë Françeskut mirënjohjen tone për dhuratën që i fali tokës Shqiptare duke pranuar t'i numërojë ndër të Lumet edhe Shërbëtorët e Hyjit Ipeshkvin Vinçenc dhe Shokët e tij, Martirë".*

Kardinali Amato në homelinë e kësaj Meshe historike për Kishën shqiptare, foli mbi martirët, mbi jetën e tyre, mbi qëndresën e tyre, mbi virtytet e tyre njerëzore e shpirtërore e për mesazhin e tyre për realitetin e sotëm.

### Lutja e hyrjes së Meshës së Lumnimit të 38 martirëve të Kishës shqiptare

O Hyj i gjithëpushtetshëm dhe i amshuar, ti ke mbushur me Shpirtin e forcës sate të lumët Vinçenc, ipeshkëv, e Shokët, martirë që t'i jepnin popullit shqiptar dëshminë e besnikërisë ndaj Krishtit dhe të dashurisë së pakushte ndaj vëllezërve.

Me ndërmjetësimin e tyre të përbashkët, jepi Kishës sate të përhapur në gjithë botën të njëjtin Shpirt që të përmbushet mbretëria e dashurisë, e drejtësisë dhe e paqes që solli Krishti Zot. Ai jeton e mbretëron me ty në bashkim me Shpirtin

Shenjt, Hyj, për të gjithë shekujt e shekujve.

**Kardinali Amato në homelinë** e kësaj Meshe historike për Kishën shqiptare, foli mbi martirët, jetën e tyre, qëndresën e tyre, mesazhin e tyre.

1. Është ditë feste sot, e jo vetëm për shqiptarët e pranishëm këtu, në Shkodër, por edhe në shumë qytete të tjera, në Shqipëri dhe jashtë saj. Vetëm dy muaj pas shenjtërimit të Nënë Terezës së Kalkutës, bijë e madhe e tokës suaj, grua heroike, pasqyrë e zemrës së mëshirshme të Hyjit, gjithnjë pranë zemrës së thyer të çdo qeniejeje njerëzore, nevojtare për ndihmë e ngushëllim, lumnimi i 38 Martirëve shqiptarë u kujton të gjithëve se në mbi këtë tokë e mira pengohet vazhdimisht prej së keqes. Megjithatë, protagonistët e vërtetë të historisë së njerëzimit nuk janë përndjekësit, por martirët.

Ndërsa përndjekësit davariten, si hijet e zezë, që shuhet përgjithmonë në errësirën e harrësës së amshuar, martirët janë pishtarë drite, që shkëlqejnë në qiellin e njerëzimit, duke u treguar të gjithëve fytyrën vërtetë të mirë të njeriut, identitetin e tij të thellë si qenie e krijuar sipas shembëllesës e përngjasimit me Zotin.

Megjithëse në ferrin e një përndjekjeje arbitrare dhe të padrejtë, martirët tuaj treguan para armiqve të tyre të njëjtat ndjenja, mbajtën të njëjtin qëndrim, që pati mbajtur Krishti: falje, besnikëri, qëndresë, vëllazëri, mëshirë. Në këtë mënyrë bëhen busulla, që na orientojnë drejt limanit të së mirës, drejt mbretërisë së Hyjit, që duhet ndërtuar edhe mbi këtë tokë.

Martirët janë dëshmitarët e atij njerëzimi të ri, që nuk mbjell në histori luftëra, përçarje e vrasje të njerëzve të pafajshëm, por paqe, gëzim



e vëllazëri, duke lartuar talentet e njëmendta të qenies njerëzore, të krijuar – siç thotë poeti Dante – «Jo për të jetuar si shtazë, por për të ndjekur virtyt dhe dije».[2]

2. Liturgjia e Fjalës na paraqet tri faza të luftës së amshuar të armikut të Hyjit mbi tokë. Leximi i parë, i marrë prej Librit të parë të Mabejve, flet për popullin e Hyjit, të mposhtur e të poshtëruar prej mbretit Antiok, pushtuesit blasfem, që ndalon flijimet e Tempullit, u lartëson altare dhe tempuj idhujve paganë, djeg librat e ligjit dhe vret gratë e fëmijët. Në këtë stuhi nuk mungojnë heronjtë që i kundërvihen shkatërrimit të kultit ndaj Hyjit të vërtetë. Shkrimi i shenjtë thotë: «Megjithëkëtë, shumica në Izrael ishte e guximshme e qëndroi e fortë e nuk hëngri ushqime të papastërta: më parë zgjodhi vdekjen se të ndotej me ushqime të papastërta e ta thyente Besëlidhjen e shenjtë» (1Mak 1,62-63).

Në Ungjill Jezusi i nxit apostujt të jenë të fortë dhe të guximshëm, kur të dorëzohen në gjyqe dhe të urrehen nga të gjithë për shkak të emrit të tij: «Mos kini frikë – thotë Zotëria – nga ata që vrasin trupin e nuk mund ta vrasin shpirtin. Kini frikë më tepër nga Ai, që mund t'jua humbë në ferr shpirtin edhe trupin» (Mt 10,28).

Shpërblimi për besnikërinë ndaj Zotit shpjegohet në Librin e Zbulesës, i cili flet për lumnimin e atyre që vijnë prej mundimit të madh dhe që i kanë larë veshjet e tyre, duke i bërë të bardha me gjakun e Qengjit. Është turma e pafundme e martirëve të çdo kombi, fisi, populli e gjuhe, që të veshur me petka të bardha dhe me degë palme në duar, rrinë pranë fronit të Hyjit. Këta «Më kurrë s'do të kenë uri, më kurrë s'do

të kenë etje, më s'do t'i djegë dielli as rrezet e tij. Sepse Qengji që është në mes, në fron, Bariu i tyre, do t'i kullosë dhe do t'i çojë në burimet e ujërave të jetës. Edhe Hyji do të fshijë çdo lot nga sytë e tyre» (krh. Zb 7,9-17).

3. Mundimi, martirizimi, lavdërimi. Ky është fati që u takoi martirëve shqiptarë. Vuajtjet e tyre shpalosin një faqe tragjike të historisë europiane. Nga njëra anë përndjekësit mizorë, nga ana tjetër martirët e pambrojtur.

Shumë vetë në atë stuhi poshtërimi dhe gjaku pyesnin se ku ishte Hyji. Por qenë vetë martirët ata që u përgjigjën se Zoti ishte me ta, i mbështeste në vuajtje, ngjitej në Kalvar me ta, pësonte me ta, qante me ta. Në martirët shqiptarë Jezu Krishti rijetonte mundimet e veta dhe vdekjen e vet. Jezusi ishte pranë Dom Lazër Shantojës kur u pushkatua në Tiranë më 5 mars 1945 dhe pranë Dom Ndre Zadejës kur u pushkatua në Shkodër më 25 mars 1945. Po ashtu, më 4 mars 1946, në orën e pushkatimit, Jezusi ngushëllonte jezuitët Giovanni Fausti e Daniel Dajani, françeskanin Gjon Shllaku, seminaristin Mark Çuni, të riun njëzet e një vjeçar Gjelosh Lulashi dhe babain e familjes Qerim Sadiku.

Veçanërisht mizore qe, për shembull, vrasja e Imzot Frano Gjinit, i ngarkuar prej ipeshkvijve katolikë të dialogonte me regjimin në pushtet. Imzot Gjini u arrestua, u akuzua për propagandë anti-komuniste, u torturua dhe pësoi urinë e etjen deri në rraskapitje. I varur në një pemë në oborrin e Sigurimit, u rrah e më pas u hodh në ujërat e zeza. Në fund u ekzekutua më 8 mars 1948 së bashku me 18 vetë të tjerë, meshtarë dhe laikë.[3] Ky guxim mbinjerëzor ishte fryt i hirit

të Krishtit që e mbështeste martirin në vuajtjet çnjerëzore të torturave.

Edhe martirët e tjerë – ndërmjet të cilëve arqipeshkvi i Durrëzit, imzot Vinçenc Prennushi – të gjykuar, të dënuar, ndonëse të pafajshëm, të torturuar dhe të vvarë, e ndjenin praninë e Krishtit. Ai ishte pranë tyre. Prej hirit të tij merrnin forcën për ta përballuar me kthjelltësi si dhe me gëzim provën e martirizimit. E dinin se do të kishin pjesë në ringjalljen e Krishtit dhe se gjaku i tyre do të ishte fara për pranverën e Kishës në Shqipëri.

4. Falë Provanisë Hyjnore, druri e Kryqit, i rrahur prej stuhisë komuniste, sot lulëzoi përsëri me një energji të përtërirë në Shqipëri, sipas shembullit të Krishtit, të kryqëzuar dhe të ringjallur. Kisha – duke kujtuar fjalën e Jezusit: «Nëse më salvuan mua, do t'ju salvojnë edhe ju» (Gjn 15,18-20) – pas shtypjes ka rilindur edhe më e shkëlqyeshme se më parë, e forcuar edhe prej dëshmisë së bijve të vet martirë.

E dimë se feja nuk kishte vdekur kurrë në Shqipëri. Kur mungonin meshtarët, qenë prindërit ata që pagëzuan fëmijët, i mësuan në fe, bekuan martesat. Njerëzit vijuan të luten e të thonë rruzaren. Vizitoheshin muzetë vetëm për të soditur kryqet dhe figurat e shenjta. Shpesh njerëzit shkonin në kishat e braktisura për t'u lutur. Kremtoheshin fshehurazi të kremtet e Krishtlindjeve dhe të Pashkëve. Pavarësisht nga ndalimi i emrave të krishterë, fëmijët shpesh në shkollë thirreshin emrin shekullar, ndërsa në shtëpi, atë të pagëzimit. Lexoheshin fshehurazi Bibla dhe librat fetarë.





Pasi kaloi stuhia, më në fund dielli i lirisë shkëlqeu përsëri mbi popullin tuaj të fortë dhe guximtar. Kur mjegulla e terrorit u davarit në vitin 1990 njerëzit filluan t'i uronin përsëri njëri-tjetrit duke buzëqeshur: "Gëzuar Pashkët". U mbyllën përfundimisht muzetë e ateizmit në Tiranë dhe në Shkodër dhe më 4 nëntor të vitit 1990 u kremtua një meshë në kapelën e varrezave të Shkodrës, pasuar nga Mesha e dytë, me pjesëmarrjen e rreth 50.000 besimtarëve. Më 25 prill 1993 Gjon Pali II bekoj gurin e parë të shenjtërores së Zojës së Këshillit të Mirë, pajtores së Shqipërisë. Kisha shqiptare, me ipeshkvijtë e vet, meshtarët dhe besimtarët, është si një lis shekullor, që erërat as stuhitë nuk mund ta shkulin, sepse mbetet i rrënjësor fort në fenë e Krishtit.

5. Po si duhet reaguari përballë mujsarive të një diktature çnjerëzore e gjakatare? Le të kujtojmë e le t'i bëjmë tonat fjalët e Papës Françesku: «Mos i harroni plagët, por mos merrni hak. Ecnj përpara duke punuar me shpresë për një të ardhme të madhe».[4]

Përballë genocidit fetar të diktaturës komuniste të shekullit të kaluar katolikët duhet të

kujtojnë dhe të falin. Kujtimi shërben për të përforcuar ftesën e Jezusit që t'i falim armiqtë, madje edhe t'i duam e të lutemi për përndjekësit. Prej martirëve katolikët duhet të trashëgojnë jo qëndrime urrejtjeje, inati dhe përçarjeje, por ndjenja dashurie, vëllazërie e harmonie. Sot katolikët, duke kujtuar bijtë e tyre martirë, duhet t'i falin, ata që i përdoqën, i keqtrajtuat, i vranë. Kjo është dhurata që Kisha katolike i bën me gëzim dhe bindje popullit shqiptar, për ta jetuar me shpirt të pajtuar bashkëjetesën me vëllazërit.

Pas disa ditës Papa Françesku do të krijojë kardinal Dom Ernest Simonin, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, të mbijetuar të përndjekjes. Fjalët e tij të para kanë qenë: «Kjo dhuratë e Atit të Shenjtë është për mua një nxitje e mëtejshme për t'u bërë mjet i shpëtimit të shpirtit, në emër të tij. Vetëm në Krishtin gjendet shpëtimi dhe sot bota ka më shumë se kurrë nevojë për këtë lajm».[5]

Shqipëria, vendi i shqipeve, përveç Gjergj Kastriotit Skënderbeut (1405-1468), të quajtur Athleta Christi nga papa Kalisti III, ka në Nënë Terezën e Kalkutës dhe në Të Lumët Martirë të

shekullit të kaluar, heronj të tjerë të lavdishëm të fesë e të atdheut, që përhapin në botë emrin e mirë të popullit shqiptar.

Martirë të Lum, lutuni për ne!

[1] E mbajtur në Shkodër (Shqipëri) më 5 nëntor 2016. Grupi i martirëve është i përbërë nga dy Ipeshkvij, njëzet e një Meshtarë Dioqezanë, shtatë Fretër Minorë, tre Jezuitë, një Seminarist dhe katër Laikë, mes të cilëve një Aspirante për jetën kushtuar Zotit.

[2] Dante, Komedia Hyjnore, Ferri, Kënga 27 rr. 118-120.

[3] krh. Joseph Ritho Mwaniki, La Chiesa cattolica in Albania, në Jan Mikrut (nën kujdesin e), La Chiesa Cattolica e il Comunismo in Europa Centro-orientale e in Unione Sovietica, Gabrielli Editori, San Pietro in Cariani (Verona), 2016 fq. 40.

[4] Papa Françesku, Vizita baritore në Shqipëri në shtator të vitit 2014.

[5] Krh. Mimmo Muolo, Simoni, dalla tortura alla porpora, në «Avvenire», 11 tetor 2016, fq. 7.

## Martirizimi i priftërinjve katolikë në shifra

Nga 27.al

881 vite burg (afro 9 shekuj) kryen priftërinjtë që kishin mbaruar studime në 24 universitete të Europës.

28 prej 38 martirëve të fesë katolike nuk kanë fare varr.

Dëshmitë më rrëqethëse të denja për në Mesjetë: Pasi ia prenë këmbët me sopatë, Dom Lazër Shantoja u pushkatua, Papa Josif Papamihali u mbyt në baltën e kënetës së Maliqit, At Serafin Koda vdiq, pasi hetuesi e mbyti me thonj në fyt, Maria Tuci u mbyll në thes me një mace dhe e qëllonin me shkop.

Të gjithë klerikët katolikë shqiptarë gjatë diktaturës komuniste kanë kryer së bashku 881 vjet burg ose afro 9 shekuj. Ndërkohë që të gjithë klerikët katolikë shqiptarë kishin kryer së bashku 450 vjet studime në 24 universitete të Europës.

Pas 22 vitesh punë kërkimore shkencore, nga e gjithë kjo e dhënë rrëqethëse, Vatikanin përzgjodhi mes tyre 38 klerikë duke i shpallur martirë, prej të cilëve vjen një fakt edhe më rrëqethës: 28 prej 38 martirëve nuk kanë fare varr.

Mes 38 klerikëve të shpallur martirë, një ishte gjerman, një polak dhe një italian. Edhe në insertin special të emisionit u bënë publike për secilin martir fundi i tyre tragjik, mes të cilëve do të veçohen si më të rëndat:

Dom Lazër Shantoja, pasi hetuesi i preu këmbët me sopatë, e pushkatuan dhe e hodhën në një gropë pa emër.

At Serafin Koda, vdiq pasi hetuesi i futi thonjtë në fyt në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Maria Tuci, pasi refuzoi të bëhej e dashura e kryetarit të degës së Brendshme të Shkodrës, u torturua duke e futur në një thes të mbyllur bashkë me një mace dhe e qëllonin me shkop.

Papa Josif Papamihali, u torturua dhe u mbyt në baltën e kënetës së Maliqit.

Imzot Jul Bonati, u mbyll pa qenë i sëmurë në çmëndinën e Durrësit dhe vdiq, teksa mjekët bënë mbi të eksperimente si një kavie.

Dom Aleksandër Sirdani, pasi u tërhoq zvarrë i lidhur pas një kali, u mbyt në një grope fekalesh.

E megjithatë ata shprehën besnikëri ndaj Jezu Krishtit, në të cilin besonin si At Gjon Shllaku që përpara se ta pushkatonin tha: Rroftë Krishti Mbret! I falim armiqtë tanë!

### GJAKU I NJË FETARI

Në kohë të regjimit,  
dënojnë një meshtar,  
duke i thënë shkakun:  
- Ti je besimtar!

E rrahën të gjorin,  
shpinës i japin dru.  
Nga burgu s'do dalësh,  
fenë pa e mohu'.

I thonë: Shkele Kryqin!  
Do të dalë më mirë.  
E kështu së shpejti,  
do të jesh i lirë.

S'mendojnë të mjerët,  
bijtë e robërisë,  
se është vetë Kryqi,  
shenja e lirisë.

Papritmas meshtari,  
Kryqin përqafoi.  
Bam! – krisi pushka,  
në ballë e qëlloi.

Gjaku i derdhur,  
bukur në mur shkroi:  
Për Krishtin vdiq,  
me Krishtin jetoj.

*Nikolin Sh. Lëmezhi  
Shkodër, nëntor 1996*

# Katolikët e ortodoksët miratojnë dokumentin mbi primatin dhe sinodalitetin

Një komisioni miks mes Kishës Katolike dhe Kishës Ortodokse lidhur me dialogun teologjik, miratoi një dokument mjaft i rëndësishëm me titull "Sinodaliteti dhe Primati në Mijëvjeçarin e Parë. Drejt një mirëkuptimi të përbashkët në shërbim të unitetit të Kishës". Mbledhja plenare që u mbajt në Chieti të Italisë nga 16 deri më 21 shtator e bashkë-kryesuar, nga pala katolike u kryesua nga kardinali Kurt Koch, president i Këshillit Papnor për Nxitjen e Bashkimit të Krishterëve e nga pala ortodokse nga kryepeshkvi i Telmessos Job Getcha, përfaqësues i Patriarkanës Ekumenike të Kostandinopojës.

Imzot Andrea Palmiero, Zëvendës-sekretari i Këshillit Papnor për Nxitjen e Bashkimit të Krishterëve duke folur mbi rëndësinë e ngjarjes vuri në dukje: "Dokumenti është rezultat i një udhe të gjatë, që e gjen nismën me dokumentin e Ravenës, i cili është miratuar më 2007. Ky dokument – që kërkoi një punë të gjatë, pasi prek njërin prej problemeve kyçe të mosmarrëveshjes ndërmjet katolikëve e ortodoksëve – shpjegon sesi në Mijëvjeçarin e Parë të Kishës primati



e sinodaliteti artikulohehin. E ky model i Mijëvjeçarit të Parë bëhet kështu, treguesi për të ardhur deri te zgjidhja e problemeve që ende ekzistojnë ndërmjet katolikëve e ortodoksëve.

Mbi domethënien e miratimit të këtij

dokumenti Imzot Andrea Palmiero ka vënë në dukje: "Është një hap, është vetëm një hap në udhën që ende duket e gjatë. Po gjithsesi, është një hap i rëndësishëm, sepse e vënë Mijëvjeçarin e Parë si tregues, si shembull, si model për të ardhur deri te mundësia e zgjidhjes së problemeve që ende janë të hapura në nivelin kishtar. Aty gjejmë jo vetëm pika referime të dobishme, por të domosdoshme për të imagjinuar ushtrimin e primatit në kontekstin e sinodalitetit, edhe në një Kishë përfundimisht të pajtuar.

Ndërkohë perspektiva e hapjes për dialogun në optikën e Imzotit gjen shprehje: "Dialogu tani ka një bazë mbi të cilën mund të vazhdojë studimin e asaj çka mund të jetë struktura, mbi të cilën Kisha mund të sigurojë bashkimin ndërmjet të gjitha Kishave të Lindjes e të Perëndimit. Ekziston një pikë e përbashkët referimi që mbështet mbi eksperiencën e Mijëvjeçarit të Parë e në interpretimin e asaj për çfarë kanë rënë dakord katolikët e ortodoksët. Ky dokument hap një shteg, por nuk i zgjidh përfundimisht të gjitha vështirësitë. Por gjithsesi, ai na mundëson, të jemi optimistë për të ardhmen.

## Ati ynë që je në qiell...!

Nga Gledis METANI

O Ati im, që je në qiell. U shenjtëroftë emri yt. Ardhtë mbretëria jote. U bëftë vullnesa jote, si në qiell, ashtu dhe në tokë. Bukën tonë të përditshme na i jep sot, na i fal mëkatet tona..... O Zot Mëkatet e mia! Jam rrëzue Zot, rrëshkita në një dhé të nxehtë, e mishi m'asht nxi si hi i pa djeg n'zjarr, po n'akull. Po më përvëlton shputat e këmbëve t'zbathta kjo tokë e nxehtë, akull. E po mi gjakos eshtrat e mia, kjo tokë e nxehtë, akull! Mbi koke, kam tetë rrathë, 8 rrëzime për me u përplas në kët' skëterrë t'thëllë. 8 fshikulime me kamzhik të përvëluem nga zjarri ku po digjeshin pak më lart ca shpirtra të mjerë! Po ku ta gjeja un mu djeg .... N'vend t'zjarrit, dorën ma përvëlton një kam e cila gdhendur ka emrin tim, vitin e mallkuar t'lindjes nga një bark që m'deshti, numrin e krijesave t'mia t'vogëla që jau pash sytë kur m'i 'lshoj nduar dashuria që njoha e mora për n'jetë t'jetëve. Kjo kam asht nduar t'mia, po unë kurrë nuk kam vra dikë ImZot. Ç'po ndodh kështu? Pse nuk mundem ti ndiej më krahët!? A mos po vdes? Po unë i vdekur jam për ty...

T'mbuluem me një shtroje t'bardhë, t'pa përlyeme gjëkund, e pash qat djalosh tek lëngonte me sy. Ja njoha plagët e ballit ku në kokë kuror gjëmbash i kishin thurur, ja njoha dhe plagt e trupit, ku përtej durve mund t'shijje ...

"ImZot" i thirra po s'mu gjegj...

"ImZot Jezus" luta, po asgje su ndreq..

E aty mes flakës mes t'merrit, aty në plagën e nëntë të Ferrit, kama ndoret lëvizi vetë, dhe u ngul n'zembrën që zembrën time krijoji në jete.

E shpoi thellë pa u dridh kurrë,

E mua gjaku n'buzë me klithi" Joo!"

Gjak zemra tij, gjak zemra ime...

E ndjeva fëshfërimën e mishit të tij tek e depërtonte tehu i metaltë i thikës, nuk ishte e denjtë t'prekte mishin e tij kjo thikë e mallkuar.

E sikur t'mos mjaftonte dhimbja më e madhe e k'tij zjarri t'egër,

M'u desh ta vrisja Zotin tim, edhe njëherë tjetër...

Edhe njëherë tjetër ...

Edhe njëherë tjetër...

"Falem Zot se s'po di ç'po bëj ...

Nuk gënjeva, nuk lakmova, nuk tradhtova, nuk ngurova, u pagëzova, u kurorëzova,

t'besova, t'deshta ....

Pse kur m'dënum me Ferr un heshta!?

Pse n'dorë kam një thikë ImZot? Pse në rreth të nëntë me tradhtarët. T'lutem ngrije kokën e më thuej, çdo në dorën time kjo kamë e huej?"

Ngriti koken, mbi dorë më vuri doren, me sytë me lot ma theu edhe atë pak jetë që m'kish mbet n'vete .... bëri me fol, dhe largoi sytë në humbësi.

"Folëm Zot" lota dhe unë përsëri.

"Nuk vrava kënd kurrë, unë kënd kurrë nuk kam vra "më preku kraharorin e m'shtyu më pa ....

E njëta kamë ngulej vetë, po kët' herë në kraharorin tim, në duart e mia, Zhgënjim, Zhgënjim!

Nuk vrava kënd askurrë jo.

Më rënd tradhtova Atë që m'desht e m'do!

E ja ku kam kët' thikë t'mprehtë:

Përher thell n'zemër Tij, përher tek unë vetë!

Atë që mdha Ai pa drejt e përbuza, e shkatërrova e tash kam humb në Zjarr,

Un mëkatova, mëkatova!

Se vet jam vrar!

# Krishti Mbret

Nga Dom Marjan LUMÇI

Sa festë e bukur por dhe e çuditshme skjo e Krishtit Mbret. Mund të themi se është një figurë emblematike, figura e këtij Mbreti që vdes në kryq. Por është besimi ynë që na përcjell deri tek fakti se ky kryq na ka dhuruar fitoren përmbi djallin, autorin e së keqes.

Thonë Etërit e Kishës që: nëse djalli do ta kishte ditur se duke i shtyrë njerëzit për të bërë të mundur që Jezusi të vdiste në Kryq në këtë mënyrë do ti ishte zbuluar njerëzimit fuqia dhe lumnia e Hyjit nëpërmjet ringjalljes së Birit të tij, do të kishte bërë ç'është e mundur që kjo gjë të mos ndodhte kurrë!

Me të vërtetë Jezusi është Kyrios, Zoti i qiellit dhe i tokës, dhe të gjithë ne jemi Mbretër bashkë me të; - mbretër mbi të gjitha vdekjet që neve kërkojnë të na fusin tmerrin; - mbretër mbi të gjitha falimentimet tona; - mbretër mbi të gjitha fyerjet që na bëhen; - mbretër mbi të gjithë ato ngjarje, fjalë apo mendime të cilat nga frika që kemi përballë vdekjes na detyrojnë që të mbetemi skllëvër të tyre.

Por... neve na intereson me të vërtetë kjo Mbretëri?

1 Korintasve. 15,55-57 "Ku është, o vdekje, fitorja e jote? Ku është, o vdekje, thimci yt? Thimci i vdekjes është mëkati dhe forca e mëkati është ligji. I qoftë lavdi Hyjit që na e jep fitoren nëpër Zotin tonë Jezu Krishtin!"

Filipianëve. 2,9-11 "Për këtë arsye Hyji e ka lartësuar dhe i ka dhënë emrin që është mbi çdo emër; që në emër të Jezusit çdo gju të përkulet, mbi tokë e në nën tokë; dhe çdo gjuhë ta dëshmojë se Jezu Krishti është Zot në nderë të Hyjit Atë."

Zbulesa. 5,9-10 Këndonin një këngë të re: Ti je i denjë ta marrësh librin dhe t'ja zgjidhësh vulat, sepse je sakrifikuar dhe i ke shpenguar për Hyjin me gjakun tënd njerëzit e çdo fisi, gjuhe, populli dhe kombësie dhe i ke bërë për Hyjin tonë mbretëri meshtarësh që do të mbretërojnë përmbi tokë».

Shejtja Terezinë: "Është e vërtetë, është e vërtetë se Zoti i zgjedh të vegjlit për ti habitur dhe hutuar të mëdhejt e kësaj bote. Unë nuk besohem në forcat e mia, por në forcën e atij që mbi Kryq ka fituar përmbi pushtetet e Ferrit"

## MEDITIM MBI KRISHTIN MBRET

Kur shikon fuguren e Krishtit Mbret, gjithçka të duket e habitshme: Sa e habitshme është të mendosh se Hyji e ban mbret Birin e vet duke e vendosur përmbi drurin e Kryqit: është shumë e habitshme dhe e vështirë ta mendosh se si kjo mbretëri është e përbërë dhe



e ngritur përmbi përvujtninë, përmbi vuajtjen dhe bashëndarjen e dhimbjes njerëzore...

Atëherë nuk më mbetet gjatjetër të mendoj përveçse, në mes të vuajtjeve që unë takoj çdo ditë, edhe unë jetoj me shumë mbretër dhe mbretëresha. Është shumë e çuditshme kur përballë një Mbreti të tillë, çdo person që vuan në këtë tokë, në fronin e vuajtjes së tij merr një veshje mbretërore.

Sa i çuditshëm Hyji: Hyji ynë na ban të bukur vetëm nëse kemi praninë e Tij brenda vetvetes tonë dhe vetëm nëse ja lëmë atij vendin e parë në jetën tonë. Kam takuar dhe takoj çdo ditë njerëz që vuajnë, njerëz që me dhimbjen e tyre shfaqin pasurinë e Dashnisë së Hyjit që kurrë nuk i braktis... Nuk më mbetet gjatjetër të mendoj përveçse të gjithë duhet të rrijmë sa më shumë e sa ma gjatë në gjuhë përballë kësaj vuajtjeje.

Fjalët e fundit të Mbretit tonë në Kryq janë fjalë të cilat na zbulojnë fytyrën e bukur të Zotit tonë, i cili pa pasë aspak kujdes për vuajtjen e Tij, duke menduar vetëm vuajtjen tonë, e sidomos atë morale, mendon vetëm për qëllimin e vuajtjes së Tij: për këtë duhet ta kuptojmë se sa e rëndësishme është ta ndjejmë së bashku me Jezusin momentin e fundit të vuajtjes në Kryq: "Kujtohu për mua" i lutet njëri prej bashkëvuajtësve të Tij... ai bashkëvuajtës jam unë... je ti... është çdo njeri që beson në vuajtjen Shëlbuese të Mbretit tonë... dhe Jezusi i përgjigjet: "sot do të jesh me mua...". Sot do të jemi me të, në vuajtjen më të madhe, në momentin më tragjik të jetës tonë; do të ndjejmë praninë e tij të ëmbël që na thotë: "SOT JE ME MUA; SOT KUJTOHEM PËR TY; SOT PO TË THEM SE TË DUA SHUMË". Janë këto fjalët e ëmbla që Zoti sot na i thotë dhe këto fjalë bëjnë që të burojnë dhe kjo lutje për të:

O Mbreti im hyjnor,  
që me plagët e dhimbjes  
ti lartësohesh në fronin mbretëror,  
ma jep gëzimin që të di me të dashtë.  
Bëj që gjithmonë ta shuaj etjen time në  
burimin e hirit tënd.

Bëj që çdo fytyrë e vuajtur,  
ta takojnë praninë tënde prej miku,  
bëj që në çdo njeri  
të mund ta gjej pasurinë e dhuratës tënde,  
bëj që në çdo çast të jetës time ta ndjej  
gëzimin tënd.

Bëj që të jetë shumë dritë në jetën time,  
në mënyrë që unë bëhen fanar shprese,  
rreze dashurie

për të gjithë ata që çdo ditë të afrohen.

Sot do të jesh me mua... - më thua,  
por ti, o Zot, tashmë më bën që të jetoj me ty.

Për çdo buzëqeshje që kam marrë,  
për çdo shtërngim dore që kam dhuru,  
për çdo përqafim që kam ndjerë...  
faleminderës, o Zot.

Ban që çdo sekondë i jetës time  
të jetë një lavd për ty,  
një falënderim për ty,  
për Ty që prej Kryqit  
më don dhe më mbështetë...

Po, o Zot, unë e di se nuk jam as  
sa një mizë e vogël,  
por në sajë të hirit që më vjen prej teje,

O ZOTI IM, UNË JAM BIRI YT.  
Amen!